



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1874/prot.

Elbasan, më 12.10.2020

VENDIM

Nr. 28 datë 12.10.2020

**"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E SENATIT
AKADEMIK NR. 24 DATË 12.04.2020, PËR MIRATIMIN E MODALITETEVE
"PËR CAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PUNËSIMIN E
PERSONELIT AKADEMIK NË UE"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, germa "d", Statutit të UE-së, neni 9, germa "d", Senati Akademik më datë 12.10.2020

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Senatit Akademik nr. 24. Datë 12.04.2020 "Për Miratimin e Modaliteteve "Për caktimin e kriterëve dhe procedurave për punësimin e personelit akademik në UE", bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
 - a. Në germën "a" të pikës 1/II/A hiqet shprehja "*Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministra përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri*".
 - b. Pas germës "b" të pikës 1/II/A shtohet pika "b/1" me këtë përmbajtje "*Kandidati që zotëron një diplomë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet ta ketë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri. Në këtë rast, nuk aplikohet kriteri i notës mesatare*".
 - c. Pas germës "b" të pikës B/II shtohet pika "b/1" me këtë përmbajtje: "*Përrjashtimisht, në rastet kur nuk ka konkurrentë që plotësojnë përcaktimet e pikës "b", vlerësimi i kandidatëve do të bëhet sipas kriterëve të tjera të kualifikimit*".
2. Ngarkohen të gjitha njësitë e UE-së për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë



KRYETARI

Prof. Dr. Skender TOPI